

## 7. **Hetimi i shkeljeve që lidhen me rendin dhe sigurinë publike**

1. **Shkelje që lidhen me rendin dhe sigurinë publike.** Paragrafi 1 i nenit 90 të Kushtetutës përcakton papërgjegjshmërinë e Presidentit për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. Klauzola e paragrafit 1 të nenit 90 të Kushtetutës nuk është dispozitë për imunitetin ndaj ndjekjes penale, sepse nuk mbulon veprimet (veprat penale) që Presidenti mund të kryejë përgjatë ushtrimit të detyrës. Klauzola e papërgjegjshmërisë mbulon vetëm aktet që ai nxjerr në ushtrim të detyrës. Klauzola i jep Presidentit mbrojtje kundrejt përgjegjesisë administrative, civile apo politike (në këtë rast përgjegjësia i kalon Kryeministrit, ministrit apo organit tjetër propozues). Klauzola ndalon Kuvendin të kryejë mocion mosbesimi apo të thërrasë në interpelancë Presidentin, por nuk e ndalon atë të nisë procedurat e shkarkimit “për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë” (paragrafi 2 i nenit 90 të Kushtetutës).

2. Kryerja e një “krimi të rëndë” (paragrafi 2 i nenit 90 të Kushtetutës) është një nga shkaqet për të nisur procedurën e shkarkimit të Presidentit të Republikës, por kjo nuk do të thotë se Presidenti i Republikës mund të përgjigjet penalisht vetëm për “krime të rënda” dhe për të tjerat mbrohet nga ndjekja penale. Parimi themelor kushtetues “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” (paragrafi 1 i nenit 18 të Kushtetutës) kërkon që Presidenti i Republikës të mbajë përgjegjësi penale, si çdo individ tjetër, për çfarëdo veprë penale, për të cilën vendoset nën akuzë nga organi kompetent.

3. Neni 223 i Kodit Penal (thirrjet publike për veprime të dhunshme) përcakton se “thirrjet e bëra publikisht për të kryer vepra të dhunshme kundër rendit kushtetues, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”. Rendi kushtetues formohet nga tërësia e parimeve themelore kushtetuese që përcaktojnë natyrën dhe organizimin e shtetit. Parlamentarizmi dhe zgjedhjet e lira janë komponent thelbësor i rendit kushtetues. Në Shqipëri “Kushtetuta garanton liritë themelore dhe, përtej disa paqartësive dhe kundërthënieve, Kodi Zgjedhor shërben si një bazë e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike”, gjë që përfshin edhe mundësinë për të kundërshtuar procedurën dhe rezultatin e zgjedhjeve. Procesi zgjedhor dhe rezultati i zgjedhjeve në një shtet ligjor mund të kundërshtohen vetëm në rrugën dhe me mjetet e përcaktuara nga ligji dhe nuk ka asnjë shkak të ligjshëm që mund të justifikojë thirrjen për të kryer veprime të dhunshme, me pasojë destabilizimin apo vënien në rrezik të zgjedhjeve. Vepra penale “thirrje publike për veprime të dhunshme” bën pjesë në grupin e veprave penale kundër rendit kushtetues dhe mund të hetohet edhe kryesisht.

4. Neni 266 i Kodit Penal (thirrja për urrejtje nacionale) përcakton se “vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”. Thirrja për urrejtje nacionale bën pjesë në grupin e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike dhe mund të hetohet edhe kryesisht. Kjo veprë drejtohet kundër “pjesëve të popullsisë”, të cilat duhet të jenë të identifikueshme qartë si objektiv i sulmeve. Përkatësia politike dhe motivi politik i sulmit mund të formojë qartësisht elementë të figurës së kësaj veprë penale.

5. Kryerja ose jo e thirrjeve publike për veprime të dhunshme apo e thirrjes për urrejtje nacionale është çështje e hetimit penal faktit. Për kuadrin ligjor të këtij hetimi parlamentar ka

rëndësi të theksohet se legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë nuk përmban klasifikimin e veprave penale në “krime të rënda” apo “krime të lehta”. Gjykimi nëse këto vepra penale formojnë krim të rëndë mund të orientohet vetëm nga fakti se ato drejtohen kundër rendit kushtetues, apo rendit dhe sigurisë publike, të cilat formojnë fusha tepër sensitive të legjislacionit penal, sidomos kur ato vendosen në kontekstin e zgjedhjeve.

6. Rezulton nga aktet që janë marrë në shqyrtim se ne shumë nga daljet e veta publike, Presidenti i Republikës ka zgjedhur të përdorë një retorikë dhune dhe të favorizojë haptazi në sytë e publikut dhunën si mjet për zgjidhjen e problemeve përkundrejt mjeteve që ofron shteti i së drejtës. Kjo retorikë dhune, e justifikuar në mbrojtje të votës nga vjedhja, ka pasur përshkallëzim të fortë deri në fund të fushatës. “Nëse një votë vidhet, do u pritët dora në sheshin Skënderbe, Kryemadhit të parit dhe të tjerat”, deklaronte Presidenti më datë 1 mars 2021, duke u ofruar shqiptarëve “drejtësinë” e Mesopotamisë së lashtë, në vend të shtetit ligjor. Më 19 prill 2021 Presidenti lëshoi thirrjen: “Gjejini (patronazhistët)! Izolojini! Mos i toleroni!...Ngruhuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundar e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!”. Më 21 prill 2021 parulla e ditës ishte: “T’i mprehin sfulqet, kosoret, lopatat, sëpatat t’i mprehin e t’i kenë gati për të dielën”.

7. Thirrjet e hapura për dhunë shkaktuan shqetësim real tek përfaqësuesit e shteteve të huaja në vend, të cilët kanë reaguar publikisht me thirrje për të ndaluar gjuhën dhe thirrjet për dhunë siç rezultojnë nga mesazhet në rrjete sociale:

**24.04.2021 Twitter – Ambasadore e SHBA Yuri Kim**

*Sot jam takuar me Kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ashtu siç jam takuar me presidentin Ilir Meta dhe Kryeministrin Edi Rama ne 48 orët e fundit. E theksojmë që ne nuk mbështesim asnjë parti apo kandidat. Por ne, në mënyrë absolute, mbështesim të drejtën e të gjithë qytetarëve për të votuar të lirë dhe të qetë.*  
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385907198040158208>

**23.04.2021 Twitter – Ambasadore e SHBA Yuri Kim**

*Është e papranueshme për këdo që të kërcënojë se qytetarët më 25 prill do të përdorin “sfulqet”, apo nëse nuk u pëlqen rezultati i zgjedhjeve. Këto kërcënime meritojnë të dënohen. Ata që nxisin dhunën do të jenë përgjegjës për rezultatet e fjalëve dhe veprimeve të tyre. Stop.*  
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385682948876378122>

**23.04.2021 Twitter – House Foreign Affairs Committee**

*“Nxisim autoritetet shqiptare për të garantuar që votuesit të mund të votojnë të lirë nga mitmarrja, intimidimi dhe dhuna.”*  
<https://twitter.com/HouseForeign/status/1385632622173380610>

**23.04.2021 Twitter – Ambasadore e SHBA Yuri Kim**

*Nxisim SPAK-un që të ndjekë ata që shkelin ligjin & pengojnë të drejtën e qytetarëve për të votuar të lirë & të qetë. Kjo përfshin ata që përfshihen në blerje votash, intimidim apo nxitje të dhunës. SPAK po heton në mënyrë*

aktive

krimet

zgjedhore.

<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385582051257159680>

### **23.04.2021 Twitter - Ambasadore e SHBA Yuri Kim**

*Është mirë të shohësh ndjesën e qartë që vjen nga Dibra. Dhuna e shkaktuar këtë javë në Elbasan nuk mund të justifikohet, nuk duhet përsëritur. Ditët e grupeve të armatosura që mbajnë shenjën e ndonjë partie politike & patrollojnë rrugët i përkasin të shkuarës – të shkuarës së shëmtuar të cilën ne të gjithë duhet ta refuzojmë. Ky incident nuk duhet përdorur për të sulmuar me ligësi një palë apo palën tjetër, për të nxitur emocion tek mbështetësit. Ai më tepër duhet të bëjë që të gjithë udhëheqësit të reflektojnë mbi mënyrën si ta udhëheqin këtë larg të shkuarës & drejt një të ardhmeje më të mirë.*  
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385526642550972418>

### **21.04.2021 U. S Embassy Statement**

*Kemi ndjekur raportimet për dhunën në Elbasan sot, e cila përfundoi në vdekjen e një personi dhe plagosjen e të tjerëve. Ne u bëjmë thirrje zyrtarëve të zbatimit të ligjit të hetojnë këtë incident sa më shpejt dhe në mënyrë të plotë, të identifikojnë autorët dhe t'i dënojnë me të gjithë forcën e ligjit. Ata që përfshihen në dhunë të tillë duhet të ndëshkohen. Ambasadorja Kim i ka kërkuar Presidentit Meta, Kryeministrit Rama dhe Kryetarit të Partisë Demokratike Basha të ushtrojnë vetëpërmbytje – dhe të udhëheqin në të njëjtën mënyrë – ndërsa çështja është duke u hetuar. Veprimet tona duhet të bazohen në fakte, jo në frikë apo thashetheme. Kur vetëm disa ditë na ndajnë nga zgjedhjet e 25 prillit, ne përsërisim deklaratën tonë të 26 marsit duke bërë thirrje që udhëheqësit – ata që janë në pushtet dhe ata që kërkojnë pushtet – të refuzojnë qartazi dhunën. Ambasada Amerikane do të vazhdojë të monitorojë situatën nga afër.*  
<https://al.usembassy.gov/u-s-embassy-statement-63/>

8. Më datë 21.04.2021 në Elbasan ndodhi një përplasje me dhunë midis dy grupeve simpatizantësh, me pasoja të rënda. Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it e përshkruan kështu ngjarjen:

*“Një person u vra dhe tre u plagosën. PD-ja kish formuar një grup, të cilin e quante “Struktura për Mbrojtjen e Votës” dhe thoshte se përbëhej nga ish anëtarë të policisë së shtetit, të cilëve PD u kish kërkuar të “verifikonin” informacionet për blerje të votës .....PD-ja përdori disa metoda ndërhyrjesh, të vetë-justifikuara në deklaratat e saj publike, për t’iu kundërvënë aktiviteteve të pretenduara të shitblerjes së votave. Më 21 prill, një person u vra dhe tre u plagosën në një incident me të shtëna armësh në Elbasan. PD-ja formoi një grup të quajtur “Struktura për Mbrojtjen e Votës”, duke u shprehur se ajo përbëhej nga ish anëtarë të policisë së shtetit, të cilëve PD-ja u kishte kërkuar të “verifikonin” informacionet e marra lidhur me shitblerjen e votave; Policia e Elbasanit*

arrestoi 10 persona të dyshuar për privim të paligjshëm të lirisë me forcë dhe deklaroi se disa prej tyre kishin qenë të armatosur. Policia ndërmori gjithashtu masa edhe ndaj “Strukturës për mbrojtjen e votës” në qarkun e Dibrës dhe të Korçës, më 23 prill...” (<https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf>)

9. Sipas raportimeve në media, autori i vrasjes në ngjarjen e Elbasanit ishte i armatosur me armë, pa leje për t’u mbajtur në publik. Ai dhe grupi që e shoqëronte shkaktuan përplasjen në tentativë për të ushtruar autoritet të kundërligjshëm policor. Modus operandi i tyre përputhet plotësisht me thirrjen publike të Presidentit të Republikës për dhunë si:

“U bëj thirrje kandidatëve të LSI në Fier të mos bien pre e provokimeve të Policisë Bashkiake për çështjen e banderolave dhe ta tejkalojnë me urtësi këtë moment. Ndërsa po u prek një votë ditën e votimeve t’i mprehin cfurqet, se si gratë trime të Libofshës do t’i ndjekim këmba këmbës horrat, nëse nuk kanë kuptuar gjë akoma.

“(https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3954232007956376)

“Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini! Izolujini! Mos i toleroni! Nuk ka patronazhist, fuks dhe bandit, që mund ta ndalë Ndryshimin e Madh më 25 Prill! 🇲🇰”...Ngrehuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundar e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!” 🇲🇰 Me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 Prillit!

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/photos/a.1479540228758912/3950093175036926/?type=3>)

“E përgëzoj kandidatën Belind Këlliçi për kapjen në flagrancë të “rilindësve” të Vaqarit, me ushqime dhe zarfe elektorale. **Opozita duhet të organizohet në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale elektorale nga të cilat Kryerilindësi nuk shkëputet dot.** As frikësimi dhe as blerja me zarfe dhe ushqime nuk e ndal Triumfin e Demokracisë dhe Sovranit më 25 Prill! Tolerancë zero për krimet zgjedhore! Ligj special për të përjashtuar përgjithmonë nga administrata vendore dhe qendrore zyrtarët, që konsumojnë krimet zgjedhore.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3955206821192228/>.)

“Në rast se do t’i thërrisja edhe njëherë shqiptarët, si me 2 mars, kam qenë i bindur, se nuk do t’i përmbaja dot. Vetëm referendumi i 25 prillit hap negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Europian. Ndëshkoni pa mëshirë me 25 prill këdo që ju bën presion me votën, këto që tenton t’ju blejë votën, këdo që ju ka mashtruar. Një votë po u prek, do pritet një dorë. Nëse Rama fiton 71 mandate me votë të lirë, unë do jap dorëheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozitës. Cilido që do guxojë në emër të popullit shqiptar të prekë votën, do u pres dorën në emër të sovranit. Vetëm populli shqiptar me votën e tij, do të mbrojë

*demokracinë. Padisë për Teatrin Kombëtar do t'i shkoj deri në fund, aferës së inceneratorëve do t'i shkoj deri në fund.*

[\(https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156/\)](https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156/)

10. Nëse Presidenti i Republikës ka qenë i përfshirë në platformën e opozitës për ngritjen dhe funksionimin e grupit paramilitar të quajtur “Struktura për Mbrojtjen e Votës”, apo jo, kjo është një çështje që vetëm hetimi i organeve kompetente mund ta zbulojë. Por, për komisionin tonë rezultoi e provuar se Presidenti i Republikës nuk ka mbajtur qëndrim ekuilibruar, por përkundrazi ka bërë deklaratat që në fakt nxisin ndasi dhe dhunë. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti, se ai për asnjë moment nuk është distancuar dhe nuk ka dënuar jo vetëm vrasjen, por as modelin e kundërligjshëm që përfaqësonte “Struktura për Mbrojtjen e Votës”. I ftuar në televizionin ‘6+1 Vlora’, Ilir Meta u shpreh se:

*“struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legjitime e opozitës, pasi sipas tij shteti është i kapur nga krimi. “Konflikti në Elbasan e stisi Edi Rama, i cili është i vetmi përgjegjës për atë situatë dhe për të gjitha zhvillimet dramatike aty. Ngjarja e rëndë ndodhi në praninë e policisë, që tregon se ky është një shtet i kapur nga krimi. Struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legjitime e opozitës, në kushtet kur Damiani në vend që të ishte sot në burg është kandidat për deputet, kur struktura kriminale të Rilindjes vazhdojnë me manovra për blerjen e votës dhe presione ndaj qytetarëve”.* (<https://abcNews.al/meta-struktura-per-mbrojtjen-e-votes-e-drejte-legjitime-e-opozites-rama-stisin-konfliktin-e-djeshem/>)

11. Figura e veprave penale që parashikohen nga neni 223 i Kodit Penal (thirrjet publike për veprime të dhunshme) dhe nga neni 266 i Kodit Penal (thirrja për urrejtje nacionale) nuk kërkon ardhjen e pasojës. Për të kryer hetimin ndaj Presidentit të Republikës organet e hetimit nuk kanë nevojë të listojnë sa akte dhune, vetëgjyqësie, apo përvetësimi të titullit apo detyrës shtetërore kanë shoqëruar thirrjet për dhunë. Ato duhet vetëm të ndajnë nëse thirrja drejtohej kundër zgjedhjeve, rezultatit të tyre dhe shumicës së zgjedhur në rrugë demokratike (rendit kushtetues), apo drejtohej kundër pjesëve të popullsisë.

12. Komisioni Hetimor nuk hetoi faktet e mësipërme të thirrjes për dhunë apo urrejtjes në kuadrin e veprave penale, pasi objekti i hetimit në këtë proces lidhet me pretendime për shkelje të rënda kushtetuese, dhe kjo është detyrë e organeve hetimore që për këto çështje mund të nisin hetimin dhe kryesisht sipas dispozitave ligjore në fuqi.

13. Komisioni Hetimor vlerëson se aktet e sjelljet e Presidentit kanë frymëzuar dhunë dhe ndasi sociale, nuk kanë kontribuar për uljen e konflikteve dhe pasqyrojnë gjuhë përçarjeje dhe urrejtjeje, sjellje që nuk përkojnë me figurën e Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit (neni 86/1 i Kushtetutës). Sipas komisionit nxitje dhune dhe ndasi dhe shembuj për të zgjidhur situatat me vetëgjyqësi, gjenden dhe në sjelljet e Presidentit që analizohen në këtë raport në lidhje me konfliktin midis FRD dhe Bashkisë Tiranë.

14. Del qartë nga transkriptimi se Presidenti me gjuhën e përdorur dhe veprimet e tij, jo vetëm nuk ndikoi për qetësimin e situatave, por përkundrazi i përshkallëzoi ato duke qenë vetë pjesëmarrjes aktiv dhe duke dhënë dhe modelin negativ se përtej mjeteve ligjore, autoriteti dhe forca mund të përdoren. Dhe të shfaqura këto sjellje nga kreu u shtetit, përbëjnë shembuj negativë që inspirojnë për dhunë e vetëgjyqësi.

15. Bazuar në sa më sipër, Komisioni konstaton shkelje të nenit 88/3 të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës pasi ai nuk ka vepruar në mbrojtje të interesit të përgjithshëm të popullit, që është siguria dhe rendi të cilat mbrohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar, duke mos treguar aspak kujdes që thirrjet e tij siç pasqyrohen më sipër janë frymëzuese për dhunë, ndasi sociale dhe urreje midis popullatës.